



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KONTRATË

KOMUNA E PODUJEVËS (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

"Te Fatosi" SH.P.K, magjistranja Prishtinë Ferizaj, me NrB:810326430 (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

DEKORIMI I SHESHIT PËR FUNDVIT me numër Identifikues 615-20-8359-2-3-6, nr i brendshëm 61520145236

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Dekorimi i sheshit për fundvit**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 24 dhjetor 2020 dhe përfundon me 10 janar 2021

1.3 Vendosja e bredhit dhe të gjitha elementet tjera dekoruese si në paramasë dhe parallogari duhet të jenë të vendosura deri më datën 28.12.2020, ndërsa demontimi dhe zhvendosja e dekorimeve duhet të bëhet më datën 10.01.2021.

1.4 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se një ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jenë: Podujevë

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **5,390.20 €;**
[pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë euro e njëzet e cent].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj sipas raportit të menaxherit të kontratës

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të shërbimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për

mashtim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën kompetente në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Menaxher i projektit do të jetë: z. Florie Mani, ing i dipl. i arkitekturës, nr tel. 044/284-682

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

| | | | |
|-------------|---|-------------|--|
| Emri: | z. Bajram Hyseni | Emri: | Rasim Fejza |
| Pozita: | Drejtor | Pozita: | menaxherit të DP |
| Nënshkrimi: |  | Nënshkrimi: |  |
| Data: | 24.12.2020 | Data: | 24/12/2020 |
| Vula: | | Vula: | |





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

Paramasa dhe Parallogaria Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit

| NR. | PËRSHKRIMI I PUNËVE | NJËSIA | SASIA | ÇMIMI ME TVSH | TOTALI EURO ME TVSH |
|-----|--|--------|-------|------------------|---------------------------|
| 1. | Furnizimi dhe montimi i bredhit artificial me konstrukcion metalik i mbuluar me degë montuese në formë bredhi natyral. Gjatësia e bredhit duhet të jetë 10m, diametri në fund të bredhit 3.7m. ndersa kyçja e bredhit në rrjet elektrik 10m. | copë | 1 | 2700 | 2700 |
| 2. | a) Furnizimi dhe montimi e dritave për bredh duhet të jen kompletë, kompleti të ketë 20 rende me nga 12 m. | copë | 3 | 33.40 | 100.20 |
| 3. | b) Në dekorimin e bredhit të vendosën edhe 100 drita flesh të tipit led të cilat reflektojnë në formë shkëndijash. | copë | 100 | 0.50 | 50 |
| 4. | c) Në dekorimin e bredhit duhet të vendosën 50 topa shkëlqyes nga 10-20cm. | copë | 50 | 1 | 50 |
| 5. | d) Në dekorimin e bredhit duhet të vendosë edhe kurdela dhe figura tjera dekoruese, madhësia 25-35 cm. | copë | 50 | 1 | 50 |
| 6. | f) Afër dekorimit të bredhit të vendosët, porta hyrse me dimensione 3x3x3m dhe e mbeshtjellur me drita dekoruese led ngjyre e kaltert ku qdo e 10drite duhet te jet blic, gjithsej duhet ti kete 480m drita | copë | 1 | 100 | 100 |
| 7. | Furnizimi dhe montimi i figurave ndriçuese nëpër shtylla 150-200 cm, gjerësia max. 1m ngjyre e bardhe -ngroht | copë | 80 | 10 | 800 |
| 8. | Furnizimi dhe montimi i dritave dekoruese në formë fije nëpër pemë (drunjë) të qytetit, komplet 20 fije x 3m, drita led të ngrohta. Gjithësejt 60 complete. | copë | 60 | 4 | 240 |

| | | | | | |
|-----|---|------|-------------------------|------|----------------|
| 9. | Furnizimi dhe montimi gyp drite per vendosjen në pemë 80-100 cm, drita led, dritat në gyp (akull) duhet të ken efekt ndriçues të "rënjes së borës" | copë | 600 | 0.70 | 420 |
| 10. | Furnizimi dhe montimi i gypit ndriçues për të vendosur në shtyllat metalike të ndriçimit për rreth sheshit me gjatësi 500 m. | m | 500 | 0.60 | 300 |
| 11. | Furnizimi dhe montimi i rrjetave ndriçuese me gjerësia 2m dhe gjatësi (8-10) m, (kompleti duhet ti kete 20 rende) qdo e 10 drite duhet te jete me blic, ngjyra të ndryshme për dekorimin e rrugës kryesore, në qendër të qytetit. Nga Objekti afarist "Beni Dona" deri te objekti i hotelierisë "Pranvera". | copë | 12 | 40 | 480 |
| 12. | Furnizimi dhe montimi i dekorimeve ajrore të portaleve metalike me drita, ngjyra e ngrohtë si dhe mirembajtja e dritave dekoruese i montuar ne sajle(litarë) metalike dhe ngjitur në pozitë horizontale prej shtylle në shtylla metalike të ndriçimit publik me gjatësi 8m-9m dhe gjerësia 1m të jenë me gypë ndriçues 220V të tipit LED, vendosur përgjat rrugës "Zahir Pajaziti"- Qendra e qytetit. | copë | 10 | 10 | 100 |
| | | | Gjithsejtë: | | 4567.97 |
| | | | TVSH 18% : | | 822.23 |
| | | | TOTALI ME TVSH : | | 5390.20 |



P.S:

Vendosja e bredhit dhe të gjitha elementet tjera dekoruese si në pozicionet e më sipërme duhet të jenë të vendosura deri më datën 25.12.2020, ndërsa demontimi dhe zhvendosja e dekorimeve duhet të bëhet me datën 20.01.2021. Të gjitha pozicionet e lart cekura duhet të mirëmbahen dhe ruhen nga punëkryesi deri në demontimin e tyre nga vetë punkryesi.